



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 88/ 2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e kompanisë ndërtimore “ARDA REI” me seli në Prishtinë, për ti hequr posterat e partive politike nga konstruksioni i urës të projektit “Ndërtimi i Rrethrotullimit në Rrugët Magjistrale M9^M2” në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Hidhet** poshtë si e pasafatshme ankesa e kompanisë ndërtimore “ARDA REI”.

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 19.01.2011, nga kompania “ARDA REI” me te cilën kërkon heqjen e posterave të partive politike nga konstruksioni i urës të projektit “Ndërtimi i Rrethrotullimit në Rrugët Magjistrale M9^M2” në Prishtinë. Sipas parashtruesit të ankesës heqja e këtyre posterave mund të shkaktoj dëme të mëdha në konstruksionin e këtij projekti te Rrethrotullimi i cili ende është në fazën e punimeve dhe me përfundimin e punimeve do të ju shkaktoj probleme ne pranimin teknik pasi qe mbesin njolla ne sipërfaqet e betonit.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 4 parasheh:

*Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet brenda shtatëdhjetedy (72) orëve.*

PZAP-i gjeti se;

**- ankesa është e pasafatshme**

PZAP-i duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore ka gjetur se ankesa është e pasafatshme per shkakun se nga shkresat e lendes konstatohet se kompania “ARDA REI” i eshte drejtuar paraprakisht KQZ-se per heqjen e posterave te subjekteve politike. Me pas KQZ-ja me date 12. 01.2011 e ka njoftuar kompanine “ARDA REI” se ankesa duhet ti drejtohet PZAP si organi kompetent per shqyrtimin e vendosjes se postereva gjate fushates zgjedhore. Parashtruesi i ankeses edhe pse pas dates 12. 01. 2011 ka qene ne dijeni te faktit se duhet ti drejtohet PZAP ka vendosur ta parashtroj

kete ankese me date 19.01.2011. Per me teper të gjitha ankesat të cilat nuk lidhen më ditën e votimit dhe numërimin duhet të parashtrihen në PZAP brenda shtatëdhjetë (72) orëve. Rrjedhimisht parashtruesi i ankesës nuk e ka shfrytëzuar afatin ligjor. Për këtë arsye si dhe bazuar ne dispozitën ligjore të cituar me larte dhe ne kuptim te nenit 115.1 te LPZ-se, PZAP vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 88/2011 më datën 26.01.2011

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

